

***STANDARDET NDËRKOMBËTARE PËR PRAKTIKËN PROFESIONALE TË
AUDITIMIT TË BRENDSHËM (STANDARDET)***

Hyrje në Standarde

Auditimi i brendshëm kryhet në mjedise të ndryshme ligjore dhe kulturore; brenda organizatave që ndryshojnë për nga qëllimi, madhësia, kompleksiteti dhe struktura dhe nga persona brenda apo jashtë organizatës. Ndërkohë që dallimet mund të ndikojnë në praktikën e auditimit të brendshëm në secilin mjedis, përputhshmëria me *Standardet ndërkombëtare të IAB mbi praktikën profesionale të auditimit të brendshëm (Standardet)* është thelbësore për përmbushjen e përgjegjësi të autorëve të brendshëm dhe për aktivitetin e auditimit të brendshëm.

Qëllimi i *Standardeve* është që të:

1. Përshkruajë parimet themelore që përfaqësojnë Kornizën e Praktikave Profesionale Ndërkombëtare.
2. Ofrojë një kornizë për kryerjen dhe nxitjen e një game të gjerë të auditimit të brendshëm me njohuri në praktika.
3. Krijojnë bazën për vlerësimin e kryerjes së auditimit të brendshëm.
4. Nxisë përmirësimin e proceseve organizative dhe të operacioneve.

Standardet janë kërkesa të detyrueshme të bazuara në parime që përbëhen nga:

- Pasqyrat e kërkesave themelore për praktikat profesionale të auditimit të brendshëm dhe për vlerësimin e efektivitetit të performancës, të cilat aplikohen ndërkombëtarisht në nivelet organizative dhe individuale.
- Interpretimet, të cilat i shpjegojnë termat ose konceptet brenda *Standardeve*.

Standardet, së bashku me Kodin e Etikës, përfshijnë të gjitha elementet e detyrueshme të Kornizës Ndërkombëtare të Praktikave Profesionale; prandaj, përputhshmëria me Kodin e Etikës dhe *Standardet* tregojnë pajtueshmërinë me të gjitha elementet e detyrueshme të Kornizës së Praktikave Profesionale Ndërkombëtare.

Standardet përdorin terma të cilave i u është dhënë kuptim i veçantë në fjalor. Për të kuptuar dhe zbatuar *standardet* në mënyrë korrekte, është e nevojshme të marrim në konsideratë kuptimet e veçanta nga Fjalori. Më hollësisht, *Standardet* përdorin fjalën “e detyrueshme” (must) për të cilësuar një kërkesë të pakushtëzuar dhe fjalën “duhet” (should) atëherë kur pritet përputhshmëria në mos, gjatë zbatimit të gjykimit profesional, rrethanat e justifikojnë devijimin.

Struktura e *Standardeve* ndahet në dy kategori kryesore: *Standardet e Atributit dhe Performancës*. *Standardet e atributit* i adresohen vetive të organizatave dhe personave që kryejnë auditimin e brendshëm. *Standardet e performancës* përshkruajnë natyrën e auditimit të brendshëm dhe ofrojnë kritere cilësore me anë të të cilave matet performanca e këtyre shërbimeve. *Standardet e atributit dhe performancës* gjithashtu ofrohen për tu zbatuar në të gjitha shërbimet e auditimit të brendshëm.

Standardet implementuese ofrohen gjithashtu për të zgjeruar *standardet e atributit dhe performancës*, duke ofruar kërkesat që aplikohen në aktivitetet e sigurimit (S) dhe të konsulencës (K).

Standardet Ndërkombëtare për Praktikën Profesionale të Auditimit të Brendshëm (Standardet)

Shërbimet e sigurimit përfshijnë vlerësimin objektiv të auditorit të brendshëm mbi evidencat për të ofruar një opinion ose konkluzione të pavarura në lidhje me një entitet, veprim, funksion, proces, sistem, ose çështje tjetër. Lloji dhe fushëveprimi i angazhimit për sigurim përcaktohen nga auditori i brendshëm. Në përgjithësi, në shërbimet e sigurimit përfshihen tre palë: (1) personi ose grupi që përfshihet drejtpërdrejt në një entitet, veprim, funksion, proces, sistem, ose çështje tjetër – pronari i procesit, (2) personi ose grupi që bën vlerësimin – auditori i brendshëm, dhe (3) personi ose grupi që e përdor vlerësimin – përdoruesi.

Shërbimet konsulente kanë natyrë këshillëdhënëse dhe zakonisht kryhen sipas kërkesave të veçanta të një klienti të angazhuar. Lloji dhe fushëveprimi i angazhimit konsulent i nënshtrohen marrëveshjes me klientin e angazhuar. Në shërbimet konsulente zakonisht janë të përfshirë dy palë: (1) personi ose grupi që ofron këshillën – auditori i brendshëm, dhe (2) personi ose grupi që kërkon ose merr këshillën – klienti i angazhuar. Gjatë kryerjes së shërbimeve konsulente auditori i brendshëm duhet të ruajë objektivitetin e tij dhe të mos marrë përgjegjësi menaxhimi.

Standardet zbatohen për auditorët e brendshëm individual dhe aktivitetete të auditimit të brendshëm. Të gjithë auditorët e brendshëm janë përgjegjës për përputhje me standardet që lidhen me objektivitetin individuale, aftësi, dhe kujdesin e duhur profesional. Përveç kësaj, auditorët e brendshëm janë përgjegjës për përputhje me standardet, të cilat janë relevante për kryerjen e përgjegjësisë të tyre të punës. Shefi Ekzekutiv i auditimit është përgjegjës për të gjitha në pajtueshmëri me standardet.

Nëse auditorët e brendshëm apo aktiviteti i auditimit të brendshëm ndalohet me ligj ose rregullore nga përputhja me pjesë të caktuara të *Standardeve*, përputhja me të gjitha pjesët e tjera të *Standardeve* dhe informacionet/shpalosjet e duhura janë të nevojshme.

Nëse Standardet janë përdorur në lidhje me kërkesat e nxjerra nga organet e tjera autoritare, komunikimet e auditimit të brendshëm mund të përmendin përdorimin e kërkesave tjera, sipas rastit. Në një rast të tillë, nëse aktiviteti i auditimit të brendshëm tregon pajtueshmërinë me Standardet dhe se ekzistojnë mospërputhje ndërmjet *Standardeve* dhe kërkesave tjera, auditorët e brendshëm dhe aktiviteti të auditimit të brendshëm duhet të jenë në përputhje me *Standardet* dhe mund të jenë në përputhje me kërkesat e tjera, nëse këto kërkesa janë më shumë kufizuese.

Rishikimi dhe hartimi i *Standardeve* është një proces në zhvillim. Bordi për standardet ndërkombëtare të auditimit të brendshëm angazhohet në këshillime dhe diskutime përpara se ti lëshojnë *Standardet*. Kjo përfshin ftesën për komente publike në të gjithë botën përmes procesit të bërjes publike të drafteve. Të gjitha draftet për ekspozim gjenden në faqen e internetit të IAB-së si dhe i dërgohen të gjitha institucioneve të IAB-së.

Sugjerimet dhe komentet në lidhje me *Standardet* mund ti dërgoni në:

The Institute of Internal Auditors
Standards and Guidance
247 Maitland Avenue
Altamonte Springs, FL 32701-4201, USA
E-mail: guidance@theiia.org

**STANDARDET NDËRKOMBËTARE PËR PRAKTIKËN PROFESIONALE TË
AUDITIMIT TË BRENDSHËM (STANDARDET)**

Standardet e atributit

1000 – Qëllimi, autoriteti, dhe përgjegjësia

Qëllimi, autoriteti dhe përgjegjësia e aktivitetit të auditimit të brendshëm duhet të përcaktohen zyrtarisht në statutin për auditim të brendshëm, në përputhje me Misionin e Auditimit të Brendshëm dhe elementet e detyrueshme të Kornizës së Praktikave Profesionale Ndërkombëtare (Parimet themelore për Praktikën Profesionale të Auditimit të Brendshëm, Kodin e Etikës, *Standardet* dhe përkufizimin e auditimit të brendshëm). Kryeshefi i auditimit duhet të rishikojë statutin e auditimit të brendshëm në mënyrë periodike dhe t'ia prezantojë atë stafit menaxhues dhe bordit për aprovim.

Interpretimi:

Statuti i auditimit të brendshëm është një dokument zyrtar i cili përcakton qëllimin, autoritetin, dhe përgjegjësinë e aktivitetit të auditimit të brendshëm. Ai përforcon pozicionin e aktivitetit të auditimit të brendshëm brenda organizatës; autorizon qasje në shënime, në personel, dhe pronë fizike që ka lidhje me performancën e angazhimit; si dhe përcakton fushëveprimin e aktiviteteve të auditimit të brendshëm. Bordi mban të drejtën për aprovimin final të statudit të auditimit të brendshëm.

1000.A1 – Natyra e shërbimeve të sigurimit që i ofrohen organizatës duhet të përcaktohen në statutin e auditimit të brendshëm. Nëse sigurimet i ofrohen palëve jashtë organizatës, lloji e këtyre sigurimeve duhet të përcaktohet po ashtu në statutin e auditimit të brendshëm.

1000.C1 – Natyra e shërbimeve konsulente duhet të përcaktohet në statutin e auditimit të brendshëm.

1010 – Pranimi i udhëzimit obligativ në Statutin e Auditimit të Brendshëm

Statuti i auditimit të brendshëm duhet të pranojë natyrën obligative të Parimeve Themelore për Praktikën Profesionale të Auditimit të Brendshëm, Kodin e Etikës, *Standardet*, dhe përkufizimi i auditimit të brendshëm. Kryeshefi i auditimit duhet të diskutojë me stafin e lartë menaxhues dhe bordin rreth Misionit të Auditimit të Brendshëm dhe elementet e detyrueshme të Kornizës Ndërkombëtare të Praktikave Profesionale.

1100 – Pavarësia dhe objektiviteti

Aktiviteti i auditimit të brendshëm duhet të jetë i pavarur, dhe auditorët e brendshëm duhet të jenë objektiv gjatë kryerjes së punës.

Interpretimi:

Pavarësia është të qenit i lirë nga kushtet që kërcënojnë mundësitë e kryerjes së një aktiviteti të auditimit të brendshëm që të përmbushë përgjegjësitë e auditimit të brendshëm në një mënyrë të paanshme. Për të arritur shkallën e nevojshme të pavarësisë për të përmbushur përgjegjësitë e auditimit të brendshëm sa më me efektivitet, kryeshefi i auditimit ka qasje të drejtëpërdrejtë dhe të

Standardet Ndërkombëtare për Praktikën Profesionale të Auditimit të Brendshëm (Standardet)

pakufizuar në stafin e lartë menaxhues dhe bord. Kjo mund të arrihet përmes një marrëdhënie të raportimit të dyfishtë. Kërcënimet që i bëhen pavarësisë duhet të menaxhohen në nivelet individuale, funksionale, angazhuese, dhe organizative.

Objektiviteti është një qëndrim intelektual i paanshëm që i mundëson auditorit të brendshëm të zbatojë angazhimet e tij në një mënyrë të tillë që i bën ata të besojnë në produktin e punës së tyre dhe se nuk janë bërë komprometime në cilësi. Kërcënimet që i bëhen objektivitetit duhet të menaxhohen në nivelet individuale, funksionale, angazhuese, dhe organizative.

1110 – Pavarësia organizative

Kryeshefi i auditimit duhet ti raportojë një nivel brenda organizatës që i mundëson aktivitetit të auditimit të brendshëm të përmbushë përgjegjësitë e tij. Kryeshefi i auditimit duhet ti konfirmojë bordit pavarësinë organizative të aktivitetit të auditimit të brendshëm, të paktën çdo vit.

Interpretimi:

Pavarësia organizative është arritur në mënyrë efektive kur shefi ekzekutiv i auditimit raporton funksionalisht te bordi. Shembuj të raportimit funksional të bordit përfshihen bordi në:

- Miratimin e statutit të auditimit të brendshëm;
- Miratimin e planin të auditimit të brendshëm bazuar në rrezik;
- Miratimin e buxhetit të auditimit të brendshëm dhe planit të burimeve;
- Marrja e komunikimit nga shefi ekzekutiv i auditimit mbi aktivitetin e auditimit të brendshëm në planin e saj të performancës dhe çështje të tjera;
- Miratimi i vendimeve në lidhje me emërimin dhe largimin e shefit ekzekutiv të auditimit;
- Miratimin e shpërblimit - pagesës së shefit ekzekutiv të auditimit;
- Kryerjen e kërkesave drejt të menaxhimit dhe shefit ekzekutiv të auditimit për të përcaktuar nëse ekzistojnë kufizime të papërshtatshme në fushën e veprimit apo në burimet e auditimit të brendshëm.

1110.A1–Aktiviteti i auditimit të brendshëm duhet të jetë i lirë nga ndërhyrjet gjatë përcaktimit të fushëveprimit të auditimit të brendshëm, kryerjes së punës, dhe komunikimit të rezultateve. Kryeshefi i auditimit duhet të japë informacione shpjeguese në bord për ndërhyrjet e tillë dhe t'i diskutojnë implikimet.

1111 – Bashkëveprimi i drejtpërdrejtë me bordin

Kryeshefi i auditimit duhet të komunikojë dhe bashkëveprojë në mënyrë të drejtpërdrejtë me bordin.

1112 – Detyrat e Kryeshefit të auditimit përtej Auditimit të Brendshëm

Kur kryeshefi i auditimit ka ose pritet të ketë role/detyra dhe / ose përgjegjësi që bien jashtë auditimit të brendshëm, duhet të ekzistojnë masat mbrojtëse për të kufizuar dëmtimet e pavarësisë ose vet objektivitetin.

Interpretimi:

Kryeshefit të auditimit mund t'i kërkohet të marrë detyra të tjera dhe përgjegjësi jashtë auditimit të brendshëm, të tilla si përgjegjësia për përputhshmërinë ose aktivitete të menaxhimit të rrezikut. Këto detyra dhe përgjegjësi mund të dëmtojnë, ose duket se do të pengojnë, pavarësinë organizative të aktivitetit të auditimit të brendshëm ose objektivitetin individual të auditorit të brendshëm. Masat mbrojtëse janë ato aktivitete të mbikëqyrjes, shpesh të ndërmarra nga bordi, për të adresuar këto dëme të mundshme, dhe mund të përfshijnë aktivitete të tilla si linja të raportimit periodik të vlerësimit dhe përgjegjësitë si dhe zhvillimin e proceseve alternative për të përfutur siguri në lidhje me fushat e përgjegjësive shtesë.

1120 – Objektiviteti individual

Auditorët e brendshëm duhet që kenë një qëndrim të drejtë, të paanshëm, dhe të shmangin çdo konflikt interesi.

Interpretimi:

Konflikti i interesit është një situatë në të cilën një auditor i brendshëm, të cilit i është dhënë besimi, ka një interes personal ose profesional konkurrimi. Interesa të tilla konkurrimi ia vështirësojnë auditorit përmbushjen e detyrave të tij/saj në mënyrë të drejtë. Konflikti i interesit ekziston edhe nëse nuk rezulton ndonjë akt i pamoralshëm ose i gabuar. Konflikti i interesit mund të krijojë formën e një sjellje të pahijshme e cila mund të rrezikojë besueshmërinë tek auditori i brendshëm, aktiviteti i auditimit të brendshëm, dhe tek vet profesioni. Një konflikt interesi do të mund të dëmtonte aftësinë e një individi për të kryer detyrat dhe përgjegjësitë e tij/saj në mënyrë objektive.

1130 – Dëmtimi i pavarësisë ose objektivitetit

Nëse pavarësia ose objektiviteti dëmtohen faktikisht ose në dukje, detajet e dëmtimit duhet ti bëhen të ditura palëve përkatëse. Lloji i njoftimit do të varet nga dëmtimi.

Interpretimi:

Dëmtimi i pavarësisë organizative dhe objektiviteti individual mund të përfshijë, por jo të kufizohet, në konfliktin e interesit personal, ndalimi i qasjes në shënime, personel, dhe prona, si dhe kufizimet e burimeve siç është financimi.

Përcaktimi i palëve të duhura të cilat do të informohen rreth dëmtimit të pavarësisë ose objektivitetit individual varet nga ajo çka pritet nga përgjegjësitë e aktivitetit të auditimit të brendshëm dhe kryeshefit të auditimit ndaj stafit të lartë menaxhues dhe bordit siç përshkruhet në statutin e auditimit të brendshëm, si dhe nga lloji i dëmtimit.

1130.A1 – Auditorët e brendshëm duhet të shmangen nga vlerësimi i veprimeve specifike për të cilat ata kanë qenë përgjegjës më parë. Objektiviteti supozohet të dëmtohet atëherë kur një auditor i brendshëm ofron shërbime sigurimi për një aktivitet për të cilin ky auditor ka pasur përgjegjësi brenda një viti më parë.

1130.A2 – Angazhimet e sigurimit për funksione mbi të cilat kryeshefi i auditimit ka përgjegjësi duhet të mbikëqyren nga një palë jashtë aktivitetit të auditimit të brendshëm.

Standardet Ndërkombëtare për Praktikën Profesionale të Auditimit të Brendshëm (Standardet)

1130.A3 - Aktiviteti i auditimit të brendshëm mund të ofrojë shërbime të sigurimit aty ku kishte kryer më parë shërbimet e konsulencës, me kusht që lloji i konsultimit nuk dëmton objektivitetin dhe me kusht që objektiviteti individual menaxhohet kur caktohet burimet për angazhim.

1130.C1 – Auditorët e brendshëm mund të ofrojnë shërbime konsulente për veprime mbi të cilat kanë qenë përgjegjës më parë.

1130.C2 – Nëse auditorëve të brendshëm i është dëmtuar pavarësia ose objektiviteti në lidhje me shërbimet konsulente të propozuara, klienti i angazhuar duhet të njoftohet përpara se ai të pranojë angazhimin.

1200 – Zotësia dhe kujdesi i duhur profesional

Angazhimet duhet të kruhen me zotësi dhe me kujdesin e duhur profesional.

1210 – Zotësia

Auditorët e brendshëm duhet të zotërojnë njohuri, aftësi, dhe shkathtësi të tjera që u nevojiten për të përmbushur përgjegjësitë e tyre individuale. Aktiviteti i auditimit të brendshëm duhet të zotërojë ose të përftojë njohuri, aftësi dhe shkathtësi të tjera që nevojiten për përmbushjen e përgjegjësisë së tij.

Interpretimi:

Njohuria, aftësitë ,dhe shkathtësitë është një term i përbashkët që i referohet zotësisë profesionale që kërkohen nga një auditor i brendshëm për të përmbushur përgjegjësitë profesionale. Kjo përfshin rishikimin e aktiviteteve aktuale, prirjet, dhe çështjet në zhvillim, për të mundësuar këshilla dhe rekomandime përkatëse. Auditorët e brendshëm inkurajohen që të demonstrojnë zotësinë e tyre duke fituar kualifikim dhe certifikata profesionale përkatëse, siç është titulli Auditor i brendshëm i certifikuar,, si dhe tituj të tjerë të ofruar nga Instituti i Auditorëve të brendshëm dhe organizata të tjera profesionale përkatëse.

1210.A1 – Kryeshefit të auditimit duhet ti ofrohen këshilla dhe asistencë nëse auditorët e brendshëm nuk kanë njohuri, aftësi, ose shkathtësi të tjera që nevojiten për përmbushjen e të gjithë angazhimit, ose një pjese të tij.

1210.A2 – Auditorët e brendshëm duhet të kenë njohuri të mjaftueshme për të vlerësuar rrezikun e mashtrimit dhe mënyrën se si menaxhohet ai nga organizata, por nuk pritet prej tyre që ketë përvojën e një personi përgjegjësia primare e të cilit është zbulimi dhe hetimi i mashtrimit..

1210.A3 – Auditorët e brendshëm duhet të kenë njohuri të mjaftueshme rreth rreziqeve dhe kontrolleve kryesore në teknologjinë informative dhe në teknikat e auditimit të bazuara në teknologji në mënyrë që të kryejnë punën që iu është caktuar. Megjithatë, jo nga të gjithë auditorët e brendshëm pritet që të kenë profesionalizmin e një auditori të brendshëm përgjegjësia primare e të cilit është auditimi i teknologjisë informative.

1210.C1 - Nëse auditorët e brendshëm nuk kanë njohuri, aftësi, ose shkathtësi të tjera që nevojiten për përmbushjen e të gjithë angazhimit, ose një pjese të tij, kryeshefi i auditimit nuk duhet të pranojë angazhimin konsulent ose marrjen e këshillave dhe asistencës të përshtatshme.

Standardet Ndërkombëtare për Praktikën Profesionale të Auditimit të Brendshëm (Standardet)

1220 – Kujdesi i duhur profesional

Auditorët e brendshëm duhet të zbatojnë kujdesin dhe aftësitë që priten ti ketë një auditor i brendshëm mjaft i matur dhe i shkathët. Kujdesi i duhur profesional nuk nënkupton pagabueshmëri.

1220.A1 – Auditorët e brendshëm duhet të praktikojnë kujdesin profesional duke marrë parasysh:

- Shkallën e punës që nevojitet për të arritur objektivat e angazhimit
- Rëndësinë, ndërlíkueshmërinë relative të çështjeve domethënëse të çështjeve në të cilat aplikohen procedurat e sigurimit;
- Përshtatshmërinë dhe efikasitetin e qeverisjes, menaxhimit e rrezikut, dhe proceset e kontrollit;
- Probabilitetin e gabimeve të rëndësishme, mashtrimeve, ose mos pajtueshmërisë
- Koston e sigurimit në lidhje me përfitimet e mundshme.

1220.A2 - Gjatë praktikimit të kujdesit të duhur profesional auditorët e brendshëm duhet të marrin parasysh përdorimin e auditimit të bazuar në teknologji dhe teknikat e tjera për analizimin e të dhënave.

1220.A3 – Auditorët e brendshëm duhet të jenë vigjilent ndaj rreziqeve të rëndësishme që mund të ndikojnë në objektivat, veprimet, ose burimet. Megjithatë, vetëm procedurat e sigurimit, edhe atëherë kur kryhen me kujdes të duhur profesional, nuk garantojnë se do të identifikohen të gjitha rreziqet.

1220.C1– Auditorët e brendshëm duhet të praktikojnë kujdesin e duhur profesional gjatë angazhimit konsulent duke pasur parasysh:

- Nevojat dhe pritjet e klientit, duke përfshirë llojin, afatin, dhe komunikimin e rezultateve të nga angazhimi;
- Ndërlíkueshmërinë relative dhe vëllimin e punës që nevojitet për të arritur objektivat e angazhimit;
- Koston e angazhimit konsulent në lidhje me përfitimet e mundshme

1230 – Zhvillimi i vazhdueshëm profesional

Auditorët e brendshëm duhet të rrisin njohuritë, aftësitë, dhe shkathhtësitë e tjera të tyre përmes zhvillimit të vazhdueshëm profesional.

1300 – Programi për përmirësimin dhe sigurimin e cilësisë

Kryeshefi i auditimit duhet të krijojë dhe të mirëmbajë një program për përmirësimin dhe sigurimin e cilësisë, i cili do të mbulonte të gjitha aspektet e aktivitetit të auditimit të brendshëm.

Interpretimi:

Programi për përmirësimin dhe sigurimin e cilësisë është dizajnuar për të mundësuar vlerësimin e përputhshmërisë së aktivitetit të auditimit të brendshëm me përkufizimin e auditimit të brendshëm dhe me Standardet, si dhe për të vlerësuar nëse auditorët e brendshëm e zbatojnë Kodin e etikës.

Programi gjithashtu vlerëson efikasitetin dhe efektivitetin e aktivitetit të auditimit të brendshëm dhe identifikon mundësitë për përmirësim. Kryeshefi i auditimit duhet të inkurajojë bordin mbikëqyrës në sigurimin e cilësisë dhe programit të përmirësimit.

Standardet Ndërkombëtare për Praktikën Profesionale të Auditimit të Brendshëm (Standardet)

1310 – Kërkesat e Programit për përmirësimin dhe sigurimin e cilësisë

Programi për përmirësimin dhe sigurimin e cilësisë duhet të përfshijë si vlerësimet e brendshme ashtu edhe ato të jashtme.

1311 – Vlerësimet e brendshme:

Vlerësimet e brendshme duhet të përfshijnë:

- Monitorimin e vazhdueshëm të performancës së aktivitetit të auditimit të brendshëm;
- Vetë vlerësimet periodike apo vlerësimet nga persona të tjerë brenda organizatës me njohuri të mjaftueshme të praktikave të auditimit të brendshëm.

Interpretimi:

Monitorimi i vazhdueshëm është një pjesë integrale e mbikëqyrjes, rishikim, dhe matjes së përditshme të aktivitetit të auditimit të brendshëm. Monitorimi i vazhdueshëm përfshihen në praktikat dhe politikat e zakonshme të aktivitetit të auditimit të brendshëm dhe përdor proceset, mjetet, dhe informacionin të konsideruara si të nevojshme për vlerësimin e përputhshmërisë me përkufizimin e auditimit të brendshëm, Kodin e etikës, dhe Standardet.

Vlerësimet periodike kryhen për të vlerësuar përputhshmërinë me përkufizimin e Auditimit të Brendshëm, Kodin e Etikës dhe Standardet.

Njohuritë e mjaftueshme të praktikave të auditimit kërkojnë të paktën njohuri të të gjitha elementeve të Kornizës ndërkombëtare të praktikave profesionale.

1312 – Vlerësimi i jashtëm

Vlerësimet e jashtme duhet të kryhen të paktën çdo 5 vjet nga një vlerësues i pavarur ose ekip vlerësues jashtë organizatës. Kryeshafi i auditimit duhet të diskutojë me bordin për:

- Forma dhe shpeshësia e vlerësimit të jashtëm
- Kualifikimet dhe pavarësinë e vlerësuesit të jashtëm, ose ekipit recensues, duke përfshirë çdo konflikt interesi të mundshëm.

Interpretimi

Vlerësimet e jashtme mund të realizohen përmes një vlerësimi të plotë të jashtëm, ose një vetë-vlerësim me vleftësim të jashtëm të pavarur. Vlerësuesi i jashtëm duhet arrijë në përfundimin në përputhje me Kodin e Etikës dhe Standardet; vlerësimi i jashtëm gjithashtu mund të përfshijë komente operative apo strategjike.

Një vlerësues apo ekipi i kualifikuar vlerësimi demonstroi kompetencë në dy fusha: praktikës profesionale të auditimit të brendshëm dhe procesi i vlerësimit të jashtëm. Kompetenca mund të demonstrohet përmes një përzierje të përvojës dhe mësimi teorik. Përvoja e fituar në organizatat e mëdha të ngjashme, kompleksitetin, sektorin, ose industri, dhe çështjet teknike është më e vlefshme se një përvojë më pak relevant. Në rastin e një ekipi vlerësues, jo të gjithë anëtarët e ekipit duhet të

Standardet Ndërkombëtare për Praktikën Profesionale të Auditimit të Brendshëm (Standardet)

ketë të gjitha kompetencat, është ekipi si tërësi që është i kualifikuar. Shefi ekzekutiv i auditimit përdor gjykimin profesional kur vlerësohet nëse një vlerësues apo ekip vlerësimi demonstroi kompetencë të mjaftueshme për t'u kualifikuar.

Një vlerësues i pavarur ose ekip vlerësimi nënkupton kur nuk ka ndonjë konflikt interesi as real dhe as në dukje dhe të mos qenit pjesë, ose nën kontrollin, e organizatës të cilës i takon aktiviteti i auditimit të brendshëm. Kryeshefi i auditimit duhet të inkurajojë bordin e mbikëqyrës në vlerësimin e jashtëm për të zvogëluar konfliktet e interesit të perceptuara apo të mundshme.

1320 – Raportimi mbi programin për përmirësimin dhe sigurimin e cilësisë

Kryeshefi i auditimit duhet t'ia komunikojë rezultatet e programit për përmirësimin dhe sigurimin e cilësisë stafit të lartë menaxhues dhe bordit. Njoftimi duhet të përfshijë:

- Shtrirjen dhe shpeshësinë e dy vlerësimeve të brendshme dhe të jashtme.
- Kualifikimet dhe pavarësinë e vlerësuesit (ve) ose ekipit vlerësues, duke përfshirë edhe konfliktet e mundshme të interesit.
- Konkluzionet e vlerësuesve.
- Planet e veprimit korrigjues.

Interpretimi:

Mënyra, përmbajtja, dhe shpeshësia e komunikimit të rezultateve të programit për përmirësimin dhe sigurimin e cilësisë caktohet në diskutimet me stafin e lartë menaxhues dhe bordin, ku dhe merren parasysh përgjegjësitë e aktivitetit të auditimit të brendshëm dhe të kryeshefit të auditimit ashtu siç janë në përmbajtjen e statutit të auditimit të brendshëm. Për të demonstruar përputhshmëri me përkufizimin e auditimit të brendshëm, Kodin e etikës, dhe Standardet, rezultatet e jashtme dhe të brendshme periodike komunikohen pasi këto vlerësime të kenë mbaruar dhe rezultatet e monitorimit të vazhdueshëm komunikohen të paktën një herë një vit. Rezultatet përfshijnë vlerësuesit ose vlerësimi i ekipit vlerësues në lidhje me shkallën e konformitetit.

1321 –Përdorimi “është në përputhje me Standardet ndërkombëtare për praktikën profesionale të auditimit të brendshëm ”

Kryeshefi i auditimit mund të deklarojë se aktiviteti i auditimit të brendshëm është në përputhje me Standardet ndërkombëtare për praktikimin profesional të auditimit të brendshëm vetëm nëse rezultatet e programit për përmirësimin dhe sigurimin e cilësisë e mbështesin këtë deklaratë.

Interpretimi:

Aktiviteti i auditimit të brendshëm është në përputhje me Kodin e Etikës dhe Standardet kur ai arrin rezultatet e përshkruara në të. Rezultatet e sigurimit të cilësisë dhe programit të përmirësimit përfshijnë rezultatet e dy vlerësimeve të brendshme dhe të jashtme. Të gjitha aktivitetet e auditimit të brendshëm do të kenë rezultatet e vlerësimeve të brendshme. Aktivitetet e auditimit të brendshëm në ekzistencë për të paktën pesë vjet gjithashtu kanë rezultatet e vlerësimeve të jashtme.

1322 – Njoftimi për mos përputhshmërinë

Kur mos përputhshmëria me Kodin e etikës, ose Standardet, ndikon në veprimtarinë ose fushëveprimin e përgjithshëm të aktivitetit të auditimit të brendshëm, kryeshefi i auditimit duhet të njoftojë stafin e lartë menaxhues dhe bordin për këtë mos përputhshmëri dhe ndikimin e saj.

Rishikuar: Tetor 2016

Në fuqi, zbatim: Janar 2017

9

Standardet Ndërkombëtare për Praktikën Profesionale të Auditimit të Brendshëm (Standardet)

Standardet e Performancës

2000 – Menaxhimi i aktivitetit të auditimit të brendshëm

Kryeshefi i auditimit duhet të menaxhojë në mënyrë efektive aktivitetin e auditimit të brendshëm për të siguruar se ai ia shton vlerën organizatës.

Interpretimi:

Aktiviteti i auditimit të brendshëm menaxhohet në mënyrë efektive atëherë kur:

- *Arrijnë qëllimin dhe përmbushin përgjegjësinë të përfshira në statutin e auditimit të brendshëm;*
- *Është në përputhje me Standardet;*
- *Personat që janë pjesëmarrës veprojnë në përputhje me Kodin e etikës dhe Standardet ;*
- *Shqyrton trendet dhe çështjet që dalin që mund të ndikojnë në organizatë.*

Aktiviteti i auditimit të brendshëm i shton vlerë organizatës dhe akterëve të saj kur shqyrton strategjitë, objektivat, dhe rreziqet; përpiqet të ofrojë mënyrat për përmirësimin e qeverisjes, menaxhimin e riskut dhe proceset e kontrollit; dhe objektivisht garanton e sigurinë duhur.

2010 – Planifikimi

Kryeshefi i auditimit duhet të hartojë një plan të bazuar në rrezik për të përcaktuar prioritetet e aktivitetit të auditimit të brendshëm në pajtueshmëri me qëllimet e organizatës.

Interpretimi:

Për të zhvilluar planin e bazuar në rrezik, kryeshefi i auditimit konsultohet me menaxhimin e lartë dhe bordin dhe merr parasysh objektivat kryesore të biznesit, rreziqet e lidhura, proceset e menaxhimit të rrezikut që përfshihen, përcaktohen në strategjinë e organizatës. Shefi ekzekutiv i auditimit duhet të rishikojë dhe të rregulloj planin, sipas nevojës, në përgjigje të ndryshimeve në biznesin e organizatës, rreziqet, operacionet, programet, sistemet dhe kontrollet.

2010.A1-Plani i angazhimeve për aktivitetin e auditimit të brendshëm duhet të bazohet mbi një vlerësim të dokumentuar të rrezikut, i ndërmarrë të paktën një herë në vit. Të dhënat nga stafi i lartë menaxhues dhe bordi duhet të merren parasysh në këtë proces.

2010.A2- Kryeshefi i auditimit duhet të identifikojë dhe të marrë parasysh pritjet e menaxhmentit të lartë, të bordit, dhe akterëve të tjerë për opinionet e auditimit të brendshëm dhe konkluzionet e tjera.

2010.C1- Kryeshefi i auditimit duhet të marrë në konsideratë që të pranojë angazhimet konsulente të propozuara duke u bazuar mbi mundësitë e këtij angazhimi për të përmirësuar menaxhimin e rrezikut, shtimin e vlerës, dhe përmirësimin e veprimeve të organizatës. Angazhimet e pranuar duhet të përfshihen në plan.

Standardet Ndërkombëtare për Praktikën Profesionale të Auditimit të Brendshëm (Standardet)

2020 – Komunikimi dhe aprovimi

Kryeshefi duhet t'ia komunikojë stafit të lartë menaxhues dhe bordit për rishikim dhe aprovim planet dhe kërkesat burimore të aktivitetit të auditimit të brendshëm, duke përfshirë ndryshimet e përkohshme të rëndësishme. Kryeshefi i auditimit duhet gjithashtu duhet të komunikojë edhe ndikimin e kufizimeve në burim.

2030 – Menaxhimi i burimit

Kryeshefi i auditimit duhet të sigurojë se burimet e auditimit të brendshëm janë të duhura, të mjaftueshme, dhe se shfrytëzohen në mënyrë efektive për të realizuar planin e aprovuar.

Interpretimi:

Termi “të duhura” i referohet përzierjes së njohurisë, aftësive, dhe shkathtësive të tjera që nevojiten për zbatimin e planit; “të mjaftueshme” i referohet sasisë së burimeve që nevojiten për realizimin e planit. Burimet shfrytëzohen në mënyrë efektive kur përdoren në një mënyrë që optimizon realizimin e planit të aprovuar.

2040 – Politikat dhe procedurat

Kryeshefi ekzekutiv duhet të hartojë politika dhe procedura për të drejtuar aktivitetin e auditimit të brendshëm.

Interpretimi:

Forma dhe përmbajtja e politikave dhe procedurave varen nga madhësia dhe struktura e aktivitetit të auditimit të brendshëm dhe ndërlikueshmërisë së punës së tij.

2050 – Koordinimi dhe mbështetja

Kryeshefi i auditimit mund të ndajë informacionin dhe të koordinojë aktivitetet me ofruesit e jashtëm dhe të brendshëm të shërbimeve të sigurimit dhe konsulencës për të siguruar përfshirjen e duhur dhe minimizuar dyfishimin e përpjekjeve.

Interpretimi:

Gjatë koordinimit të aktiviteteve, Kryeshefi i auditimit mund të mbështetet në punën e ofruesve të tjerë të sigurimit dhe të shërbimeve këshilluese. Një proces i qëndrueshëm për bazën e mbështetjes duhet të krijohet, dhe Kryeshefi i auditimit duhet të marrë parasysh zotësin, objektivitetin dhe kujdesin e duhur profesional të ofruesve të shërbimeve të sigurimit dhe konsulente. Kryeshefi i auditimit duhet gjithashtu të ketë një njohuri të qarta për fushëveprimin, objektivat dhe rezultatet e punës së kryer nga ofruesit e tjerë të sigurimit dhe shërbimeve të konsulencës. Kur mbështetja është vendosur në punën e të tjerëve, shefi ekzekutiv i auditimit është ende llogaridhënës dhe përgjegjës për të siguruar mbështetjen e duhur për konkluzionet dhe opinionet e arritura nga aktiviteti i auditimit të brendshëm

Standardet Ndërkombëtare për Praktikën Profesionale të Auditimit të Brendshëm (Standardet)

2060 – Raportimi tek stafi i lartë menaxhues dhe bordi

Kryeshefi i auditimit duhet ti raportojë në mënyrë periodike stafit të lartë menaxhues dhe bordit mbi qëllimin, autoritetin, përgjegjësinë e aktivitetit të auditimit të brendshëm si dhe performancës në lidhje me planin e tij, dhe në përputhje me Kodin e Etikës dhe Standardet. Raportimi duhet të përfshijë çështje të rëndësishme të kontrollin dhe ekspozimin ndaj rrezikut, duke përfshirë rrezikun nga mashtrimi, çështje të qeverisjes, dhe çështje të tjera të nevojshme ose të kërkuara nga stafi i lartë menaxhues dhe bordi.

Interpretimi:

Shpeshësia dhe përmbajtja e raportimit përcaktohen në diskutim me stafin e lartë menaxhues dhe bordin, si dhe varen nga rëndësia e informacionit që do të komunikohet dhe nga urgjenca e veprimeve përkatëse që duhet të merren nga stafi i lartë menaxhues dhe bordi.

Raportimi i kryeshefit ekzekutiv të auditimit dhe komunikimi tek menaxhment i lartë dhe bordi duhet përfshijnë informacion në lidhje me:

- *Statuti i auditimit.*
- *Pavarësia e aktivitetit të auditimit të brendshëm.*
- *Plani i auditimit dhe progresi kundrejt planit.*
- *Kërkesat e burimeve.*
- *Rezultatet e aktiviteteve të auditimit.*
- *Përputhshmëria me Kodin e Etikës dhe Standardet dhe planeve të veprimit për të adresuar ndonjë çështje të rëndësishme të përputhshmërisë.*
- *Përgjigja e menaxhmentit ndaj rrezikut që në gjykimin e kryeshefit ekzekutiv të auditimit, mund të jetë i papranueshëm për organizatën.*

Këto dhe kërkesat e tjera të komunikimit kryeshefit ekzekutiv të auditimit përmenden në të gjitha standardet.

2070 - Ofruesi i jashtëm Shërbimit dhe Përgjegjësia organizative për Auditimin e Brendshëm

Kur një ofrues i jashtëm i shërbimit shërben si aktivitet i auditimit të brendshëm, ofruesi duhet të vejë në dijeni organizatën se ajo ka përgjegjësinë për mbajtjen e një aktiviteti efektiv të auditimit të brendshëm.

Interpretimi:

Kjo përgjegjësi tregohet nëpërmjet programit të siguri dhënies dhe përmirësimit të cilësisë i cili vlerëson përputhshmërinë me Përkufizimin e Auditimit të Brendshëm, Kodin e Etikës dhe Standardet.

2100 – Natyra e punës

Aktiviteti i auditimit të brendshëm duhet të vlerësojë dhe të kontribuojë në përmirësimin e qeverisjes, menaxhimit të rrezikut, dhe proceset e kontrollit duke përdorur një qasje sistematike dhe të disiplinuar. Besueshmëria e auditorit të brendshëm dhe vlera rriten kur auditorët janë proaktiv dhe vlerësimet e tyre të ofrojnë mendime të reja dhe marrin parasysh ndikimin në të ardhmen.

2110 – Qeverisja

Aktiviteti i auditimit të brendshëm duhet të vlerësojë dhe të bëjë rekomandimet e duhura për përmirësimin e procesit të qeverisjes së organizatës:

- Marrja e vendimeve strategjike dhe operacionale.
- Mbikëqyrja e menaxhimit të rrezikut dhe kontrollit.
- Promovimi i etikës dhe vlerave të duhura brenda organizatës.
- Sigurimi i menaxhimit efektiv të performancës organizative dhe llogaridhënies.
- Komunikimi i informacionit të rrezikut dhe kontrollit në zonat e duhura të organizatës.
- Koordinimi i aktiviteteve dhe komunikimi i informacionit mes bordit, auditorët e jashtëm dhe të brendshëm, ofruesit e tjerë të sigurimit, dhe menaxhimi.

2110.A1 - Aktiviteti i auditimit të brendshëm duhet të vlerësojë dizajnin, zbatimin, dhe efikasitetin e objektivave, programeve dhe aktiviteteve etike të organizatës.

2110.A2 – Aktiviteti i auditimit të brendshëm duhet të vlerësojë nëse qeverisja e teknologjisë informative e organizatës mbështet strategjitë dhe objektivat e organizatës.

2120 – Menaxhimi i rrezikut

Aktiviteti i auditimit të brendshëm duhet të vlerësojë efikasitetin dhe të kontribuojë në përmirësimin e proceseve të menaxhimit të rrezikut.

Interpretimi:

Përcaktimi nëse proceset e menaxhimit të rrezikut janë efektive vjen si vlerësim që rezulton nga vlerësimi i auditorit të brendshëm se:

- *Objektivat organizative përkrahin dhe janë të harmonizuar me misionin e organizatës;*
- *Rreziqet e rëndësishme janë identifikuar dhe vlerësuar;*
- *Përgjigjet e duhura ndaj rrezikut janë përzgjedhur që i radhitin rreziqet me rreziqet e pranueshme të organizatës;*
- *Informacioni relevant për rrezikun është marrë dhe komunikuar në kohën e duhur nëpër organizatë, duke i mundësuar stafit, stafit menaxhues dhe bordit që të përmbushin përgjegjësitë e tyre.*

Aktiviteti i auditimit të brendshëm mund të mbledhë informacionin për të mbështetur këtë vlerësim gjatë disa angazhimeve. Rezultatet e këtyre angazhimeve, kur shikohen së bashku, bëjnë të mundur njohjen dhe kuptimin e proceseve të menaxhimit të rreziqeve të organizatës dhe efektivitetit të tyre.

Proceset e menaxhimit të rrezikut monitorohen përmes aktiviteteve të vazhdueshme të menaxhimit, vlerësimeve të ndara, ose nga të dyja së bashku.

2120.A1- Aktiviteti i auditimit të brendshëm duhet të vlerësojë ekspozimin ndaj rrezikut në lidhje me qeverisjen, veprimet, sistemet informative të organizatës, që kanë të bëjnë me:

- Arritjen e objektivave strategjike të organizatës;
- Besueshmërinë dhe integritetin e informacionit operativ dhe financiar.
- Efikasitetin dhe efektivitetin e veprimeve dhe programet.

Standardet Ndërkombëtare për Praktikën Profesionale të Auditimit të Brendshëm (Standardet)

- Ruajtjen e pasurive;
- Pajtueshmërinë me ligjet, rregulloret, politikat, procedurat dhe kontratat.

2120.A2 – Aktiviteti i auditimit të brendshëm duhet të vlerësojë mundësinë që një mashtrim mund të ndodhë dhe mënyrën se si organizata e menaxhon rrezikun për mashtrim.

2120.C1 – Gjatë angazhimeve konsulente, auditorët e brendshëm duhet të adresojnë rrezikun në përputhje me objektivat e angazhimit dhe duhet të jenë vigjilent ndaj ekzistimit të ndonjë rreziku tjetër të rëndësishëm.

2120.C2 – Auditorët e brendshëm duhet të përfshijnë njohurinë mbi rrezikun që e kanë fituar gjatë angazhimeve konsulente në vlerësimin që ata i bëjnë proceseve të menaxhimit të rrezikut të organizatës.

2120.C3 – Gjatë asistimit të stafit menaxhues për krijimin ose përmirësimin e proceseve për menaxhimin e rrezikut, auditorët e brendshëm duhet të mënjanojnë marrjen e ndonjë përgjegjësie menaxhimi kur faktikisht bëjnë menaxhimin e rrezikut.

2130 – Kontrolli

Aktiviteti i auditimit të brendshëm duhet të ndihmojë organizatën që të ruajë kontrollet efektive duke vlerësuar efikasitetin dhe efektivitetin e tyre si dhe duke nxitur përmirësime të vazhdueshme.

2130.A1- Aktiviteti i auditimit të brendshëm duhet të vlerësojë përshtatshmërinë dhe efikasitetin e kontroleve duke iu përgjigjur rreziqeve brenda qeverisjes, veprimeve, sistemeve informative të organizatës, që kanë të bëjnë me:

- Arritjen e objektivave strategjike të organizatës
- Besueshmërinë dhe integritetin e informacionit operativ dhe financiar.
- Efikasitetin dhe efektivitetin e veprimeve dhe programet.
- Ruajtjen e pasurive;
- Pajtueshmërinë me ligjet, rregulloret, politikat, procedurat dhe kontratat

2130.C1 – Auditorët e brendshëm duhet ti përfshijnë njohuritë e tyre mbi kontrollin të fituara nga angazhimet konsulente për vlerësimin që i bëjnë proceseve të kontrollit të organizatës.

2200 – Planifikimi i angazhimit

Auditorët e brendshëm duhet të hartojnë dhe dokumentojnë një plan për çdo angazhim, duke përfshirë edhe objektivat, fushëveprimin, qëllimin, afatet kohore, dhe ndarjen e burimeve të angazhimit. Plani duhet të marr në konsideratë strategjitë, objektivat dhe rreziqet e organizatës që janë relevante për angazhim.

2201 – Çka duhet të merret parasysh gjatë planifikimit

Gjatë planifikimit të angazhimit, auditorët e brendshëm duhet të marrin parasysh:

- Strategjitë dhe objektivat e aktivitetit i cili recenohet-rishikohet dhe mjetet me të cilat aktiviteti kontrollon performancën e tij.
- Rreziqet e rëndësishme ndaj aktivitetit, objektivat e tij, burimet, veprimet, dhe mjetet me të cilat ndikimi i mundshëm i rrezikut mbahet në një nivel të pranueshëm.

Standardet Ndërkombëtare për Praktikën Profesionale të Auditimit të Brendshëm (Standardet)

- Efektiviteti dhe mjaftueshmëria-përshtatshmëria e qeverisjes së veprimtarisë, menaxhimit të rrezikut dhe proceseve të kontrollit e krahasuara me një kuadër përkatës të kontrollit ose model.
- Mundësitë për të bërë përmirësime të rëndësishme për qeverisjen e veprimtarisë, menaxhimin e riskut, proceseve të kontrollit.

2201.A1- Gjatë planifikimit të një angazhimi për palët jashtë organizatës, auditorët e jashtëm duhet të bëjnë një dokument të shkruar mirëkuptimi rreth objektivave, fushëveprimit, përgjegjësiwe përkatëse, dhe pritjeve të tjera duke përfshirë kufizimet në shpërndarjen e rezultateve të angazhimit dhe qasjen në të dhënat e angazhimit.

2201.C1- Auditorët e brendshëm duhet të kenë një mirëkuptim me klientët e angazhimit konsulent rreth objektivave, fushëveprimit, përgjegjësiwe përkatëse dhe pritjet e tjera të klientit. Për angazhimet e rëndësishme ky mirëkuptim duhet të dokumentohet.

2210 – Objektivat e angazhimit

Objektivat duhet të krijohen për çdo angazhim.

2210.A1- Auditorët e brendshëm duhet të kryejnë një vlerësim paraprak të rrezikut përkatës në lidhje me aktivitetin të cilit i bëhet recensionit. Objektivat e angazhimit duhet të reflektojnë rezultatet e këtij vlerësim.

2210.A2- Auditorët e brendshëm duhet të marrin parasysh probabilitetin e gabime të rëndësishme, mashtrimeve, dhe ekspozimeve të tjera gjatë hartimit të objektivave të angazhimit.

2210.A3- Kriteria adekuate nevojiten për të vlerësuar qeverisjen, menaxhimin e riskut dhe kontrollet. Auditorët e brendshëm duhet të konstatojnë nivelin në të cilin stafi menaxhues dhe/ose bordi i ka hartuar kriteret adekuate për të përcaktuar nëse janë arritur objektivat dhe qëllimet. Nëse janë adekuate, auditorët e brendshëm duhet ti përdorin këto kriteria në vlerësimet e tyre. Nëse nuk janë adekuate, auditorët e brendshëm duhet të punojnë me stafin menaxhues dhe /ose bordi për ti hartuar kriteret e duhura për vlerësim.

Interpretimi:

Llojet e kriterëve mund të përfshijnë:

- *Të brendshme (p.sh., politikat dhe procedurat e organizatës).*
- *Të jashtme (p.sh., ligjet dhe rregulloret e vendosura nga organet statutore).*
- *Praktikat kryesorë (p.sh., industria dhe udhëzime profesionale).*

2210.C1 - Objektivat e angazhimit për konsultim duhet të adresojnë qeverisjen, menaxhimin e rrezikut, dhe proceset e kontrollit në masën rënë dakord me klientin.

2210.C2 - Objektivat e angazhimit për konsultim duhet të jenë në përputhje me vlerat, strategjitë dhe objektivat e organizatës.

2220 –Fushëveprimi i angazhimit

Rishikuar: Tetor 2016

Në fuqi, zbatim: Janar 2017

15

Standardet Ndërkombëtare për Praktikën Profesionale të Auditimit të Brendshëm (Standardet)

Fushëveprimi i përcaktuar duhet të jetë i mjaftueshëm për të arritur objektivat e angazhimit.

2220.A1 - Fushëveprimi i angazhimit duhet të përfshijë konsideratën ndaj sistemeve, regjistrave, personelit, dhe pasurisë fizike relevante dhe duke përfshirë gjithashtu edhe ato që janë nën kontrollin e palëve të treta.

2220.A2 - Nëse mundësi për konsultim të rëndësishëm ndodhin gjatë angazhimit të sigurimit, një marrëveshje në të shkruar duhet të arrihet sikurse tek objektivat, fushëveprimi, përgjegjësitë

përkatëse, dhe pritjet e tjera dhe rezultatet e angazhimit konsulent duhet të komunikohen në pajtueshmëri me standardet konsulente apo këshilluese.

2220.C1 - Gjatë kryerjes së angazhimit konsulent, auditorët e brendshëm duhet që të sigurohen se fushëveprimi i angazhimit është i mjaftueshëm në mënyrë që të adresojnë objektivat e pajtuara. Nëse Auditorët e brendshëm zhvillojnë rezerva në lidhje me fushëveprimin përgjatë angazhimit, këto rezerva duhet të diskutohen me klientin për të përcaktuar se a duhet të vazhdojnë me angazhimin.

2220.C2 - Gjatë angazhimeve të konsulencës, auditorët e brendshëm duhet të adresojnë kontrollin në përputhje me objektivat e angazhimit dhe të jenë vigjilent për çështje të rëndësishme të kontrollit.

2230 – Alokimi i burimeve të angazhimit

Auditorët e brendshëm duhet që të përcaktojnë burime të mirëfillta dhe të mjaftueshme për arritjen e objektiveve të angazhimit duke u bazuar në vlerësimin e natyrës dhe kompleksitetit të secilit angazhim, kufizimet e kohës dhe burimet në dispozicion.

Interpretimi:

Përshtatshmëria i referohet përzierjes së njohurive, aftësive dhe kompetencave të tjera të nevojshme për të kryer angazhimin. Mjaftueshmëria i referohet sasisë së burimeve të nevojshme për të kryer angazhimin me kujdesin e duhur profesional.

2240 – Programi i punës së angazhimit

Auditorët e brendshëm duhet të zhvillojnë dhe dokumentojnë programe të punës të cilat arrijnë objektivat e angazhimit.

2240.A1- Programet e punës duhet të përfshijnë procedurat për identifikimin, analizimin, vlerësimin dhe dokumentimin e informatave gjatë angazhimit. Programi i punës duhet që të aprovohet para se të implementohet, dhe çfarëdo përshtatje duhet të aprovohet në mënyrë të rregullt.

2240.C1 – Programet punuese për konsultimin e angazhimit mund të ndryshojnë nga përmbajtja varësisht nga natyra e angazhimit.

2300 – Kryerja e angazhimit

Auditorët e brendshëm duhet të identifikojnë, analizojnë, vlerësojnë dhe dokumentojnë informata të mjaftueshme për të arritur objektivat e angazhimit.

2310 – Identifikimi i informacionit

Rishikuar: Tetor 2016
Në fuqi, zbatim: Janar 2017

16

Standardet Ndërkombëtare për Praktikën Profesionale të Auditimit të Brendshëm (Standardet)

Auditorët e brendshëm duhet të identifikojnë informata të mjaftueshme, të besueshme, relevante dhe të dobishme për të arritur objektivat e angazhimeve.

Interpretimi:

Informatat e mjaftueshme janë faktike, adekuate, dhe bindëse duke mundësuar kështu që një person i matur, i informuar të vinte deri te konkluzioni sikurse auditori. Informacion i besueshëm është informacioni më i mirë i arritshëm përmes përdorimit të teknikave të duhura të angazhimit. Informatat relevante mbështetin vërejtjet dhe rekomandimet e angazhimit dhe është në përputhje me objektivat e angazhimit. Informatat e dobishme ndihmojnë organizatën për të përmbushur qëllimet e saj.

2320 – Analizimi dhe vlerësimi

Auditorët e brendshëm duhet të bazojnë rezultatet e konkluzioneve dhe angazhimeve me analiza dhe vlerësime të duhura.

2330 – Dokumentimi i informacioneve

Auditorët e brendshëm duhet të dokumentojnë informacionet relevante për të mbështetur konkluzionet dhe rezultatet e angazhimit.

2330.A1- Kryeshefi i auditimit duhet të kontrollojë qasjen në regjistrat e angazhimeve. Kryeshefi i auditimit duhet të marr miratimin apo aprovimin nga stafi i lartë menaxhues dhe ose zyrtarit ligjor para se të lëshoj regjistra të tillë tek palët e jashtme, sipas rastit.

2330.A2- Kryeshefi i auditimit duhet të zhvilloj kërkesat për mbajtjen e dosjes së regjistrave të angazhimit, pavarësisht se nga vendi në të cilin regjistrat janë të deponuar apo të ruajtur. Këto kërkesa duhet të mbahen në përputhje me udhëzimet e organizatës dhe çdo kërkesë përkatëse rregullatore apo kërkesave të tjera.

2330.C1- Shefi ekzekutiv i auditimit duhet të zhvillojnë politika qeverisëse mbi kujdestarinë dhe mbajtjen e regjistrave të angazhimit, e gjithashtu edhe lirimimin apo ofrimin e tyre ndaj palëve të brendshme apo të jashtme. Këto rregullore duhet të jenë në pajtueshmëri me udhëzimet e organizatës dhe çdo kërkesë përkatëse rregullatore ose kërkesave të tjera.

2340 – Mbikëqyrja e angazhimit

Angazhimet duhet të jenë të mbikëqyrura në mënyrë të rregullt për tu siguruar se objektivat janë arritur, kualiteti është siguruar dhe personeli është zhvilluar apo ngritur.

Interpretimi:

Kërkesa e nivelit të mbikëqyrjes do të varet nga profesionalizmi dhe përvoja e auditorëve të brendshëm dhe nga kompleksiteti i angazhimit. Kryeshefi i auditimit ka përgjegjësi të përgjithshme për mbikëqyrjen e angazhimit, pavarësisht a është e kryer nga apo për aktivitetin e auditimit të brendshëm, por mund të caktoj në mënyrë të përshtatshme anëtarë me përvojë për aktivitete të auditimit të brendshëm për të kryer rishikimin. Evidencat e një mbikëqyrje të duhur duhet të dokumentohet dhe të ruhet.

2400 – Komunikimi i rezultateve

Rishikuar: Tetor 2016
Në fuqi, zbatim: Janar 2017

17

Standardet Ndërkombëtare për Praktikën Profesionale të Auditimit të Brendshëm (Standardet)

Auditorët e brendshëm duhet ti komunikojnë rezultatet e angazhimit.

2410 – Kriteret e komunikimit

Komunikimet duhet të përfshijnë objektivat, fushëveprimin dhe rezultatet e angazhimit.

2410.A1 - Komunikimi përfundimtar i rezultateve të angazhimit duhet të përfshijë konkluzionet e aplikueshme, si dhe rekomandime të zbatueshme dhe / ose planet e veprimit. Kur është e përshtatshme, opinioni i auditorit të brendshëm duhet të sigurohet. Opinioni duhet të marrë parasysh pritjet e menaxhimit të lartë, bordit, dhe aktorëve të tjerë dhe duhet të mbështetet nga informata të mjaftueshme, të besueshme, relevante dhe të dobishme.

Interpretim:

Opinionet në nivelin e angazhimit mund të jenë vlerësime, konkluzione, ose përshkrime të tjera të rezultateve. Një angazhim i tillë mund të jetë në lidhje me kontrollin rreth një procesi të veçantë, rreziku, apo njësie të veçantë të biznesit. Formulimi i mendimeve të tilla kërkon marrjen në konsideratë të rezultateve të angazhimit dhe rëndësinë e tyre.

2410.A2- Auditorët e brendshëm janë të inkurajuar të vërtetojnë performancë të kënaqshme në komunikimin e angazhimit.

2410.A3- Kur të ofrohen rezultatet e angazhimit tek palët jashtë organizatës, komunikimi duhet të përfshijë kufizimin e shpërndarjes dhe përdorimit të rezultateve.

2410.C1- Komunikimi i përparimit dhe rezultateve të angazhimeve konsulente do të ndryshojnë në formë dhe përmbajtje varësisht nga lloji i angazhimit dhe nevojat e klientit.

2420 – Kualiteti i komunikimeve

Komunikimet duhet të jenë të sakta, objektive, të qarta, koncize, konstruktive, kompletuar, dhe me kohë.

Interpretimi:

Komunikimet e sakta nuk përmbajnë gabime dhe shtrembërime dhe janë plotësisht të besueshme duke nënvizuar faktet. Komunikimet objektive janë të drejta, të paanshme, dhe janë rezultate të një vlerësimi të drejtë dhe të balancuar të të gjitha fakteve dhe kushteve relevante. Komunikimet e qarta kuptohen lehtë dhe janë logjike, duke shmangur gjuhën teknike të panevojshme dhe ofrojnë të gjitha informatat e rëndësishme dhe relevante. Komunikimet koncize janë deri në një masë dhe shmangin elaborimet e panevojshme, detale të panevojshme, dhe fjalë të tepërta. Komunikimet konstruktive janë ndihmesë për klientin e angazhuar dhe organizatën dhe udhëheqin drejt përparimit sipas nevojës. Komunikimeve komplete nuk duhet t'ju mungoj asgjë që është esenciale për audiencën e planifikuar dhe përmbajnë të gjitha informatat madhore dhe relevante si dhe observimet për të mbështetur rekomandimet dhe konkluzionet. Komunikimet me kohë janë të përshtatshme dhe ekspeditive, varësisht nga rëndësia e përdorimit, duke i lejuar stafit të marrë veprime konkrete dhe të përshtatshme korrektuese.

2421 – Gabimet dhe mangësitë

Rishikuar: Tetor 2016
Në fuqi, zbatim: Janar 2017

18

Standardet Ndërkombëtare për Praktikën Profesionale të Auditimit të Brendshëm (Standardet)

Nëse komunikimi final përmban gabime dhe mangësi të rëndësishme, kryeshefi i auditimit duhet të komunikoj informata korrektuese për të gjitha palët të cilat kanë pranuar informatat origjinale të komunikimit.

2430 – Përdorimi i "Kryerjes së Auditimit të Brendshëm në Pajtueshmëri me Standardet Ndërkombëtare për Praktikën Profesionale të Auditimit të Brendshëm"

Dëshmimi se angazhimet e tyre janë "*kryer në pajtueshmëri me Standardet Ndërkombëtare për Praktikën Profesionale të Auditimit të Brendshëm*" është i duhur vetëm nëse mbështet nga rezultatet e sigurimit të kualitetit si dhe programit të përmirësuar.

2431 – Komunikimi i mos përputhjes të angazhimit

Kur mospërputhja me Kodin e Etikës apo Standardet ndikon në një angazhim të veçantë, komunikimi i rezultateve duhet të bëjë të ditur:

- Dispozitat apo rregullat e Kodit të Etikës apo standardi(et) me të cilat nuk është arritur përshtatshmëria e plotë;
- Arsyen (et) për mospërputhje; dhe
- Ndikimin e mospërputhjes në angazhim dhe rezultatet e komunikuara të angazhimit.

2440 – Shpërndarja e rezultateve

Kryeshefi i auditimit duhet të komunikoj rezultatet tek palët e duhura.

Interpretimi:

Kryeshefi i auditimit është përgjegjës për shqyrtimin dhe miratimin e komunikimit përfundimtar të angazhimit përpara lëshimit dhe për të vendosur për të cilin dhe si do të shpërndahen. Krerët e delegatët ekzekutiv të auditimit këto detyra, ai ose ajo mban përgjegjësi të plotë. Kur kryeshefi i auditimit delegon këto detyra, ai ose ajo mban përgjegjësinë e përgjithshme.

2440.A1- Kryeshefi i auditimit është përgjegjës për komunikimin e rezultateve finale tek palët të cilat mund të sigurojnë se rezultateve të ofruara u është dhënë konsiderata e nevojshme.

2440.A2- Nëse nuk janë të mandatuara ndryshe me kërkesa ligjore, statusore, apo kërkesa rregullatore, para se të lëshohen rezultatet tek palët jashtë organizatës, kryeshefi i auditimit duhet të:

- Vlerësojë potencialin e rrezikut ndaj organizatës;
- Konsultohet me stafin e lartë menaxhues dhe /apo konsultohet në çështjet ligjore në pajtueshmëri; dhe
- Kontrollon përhapjen-publikimin duke ndaluar përdorimin e rezultateve.

2440.C1- Kryeshefi i auditimit është përgjegjës për komunikimin e rezultateve finale duke konsultuar angazhimet ndaj klientëve.

2440.C2- Gjatë angazhimeve konsulente, qeverisja, menaxhimi i rrezikut, dhe çështjet kontrolluese mund të identifikohen. Kur do që këto çështje janë të rëndësishme për organizatën, ato duhet të jenë të komunikuara tek stafi i lartë menaxhues si dhe tek bordi.

2450 – Opinionet e përgjithshme

Kur një opinion i përgjithshëm është lëshuar, ai duhet të marrë parasysh strategjitë, objektivat dhe rreziqet e organizatave dhe pritjet e menaxhmentit të lartë, të bordit dhe akterëve të tjerë dhe duhet të mbështetet nga të dhëna të mjaftueshme, të besueshme, relevante dhe të dobishme.

Interpretimi :

Komunikimi duhet të identifikoj:

- *Fushëveprimin, duke përfshirë periudhën kohore të cilës i takon opinionin*
- *Kufizimet e fushëveprimit;*
- *Shqyrtimin e të gjitha projekteve të lidhura, duke përfshirë mbështetjen në ofruesit e tjerë të sigurisë ;*
- *Përmbledhjen e informacioneve të cilat e mbështesin opinionin*
- *Kornizën e rreziqeve ose të kontrollit ose kriteret e tjera të përdorura si baze për opinionin e përgjithshëm, dhe*
- *Opinionin e përgjithshëm, gjykimin, apo konkluzionin e arritur;*

Arsyet për një opinion të përgjithshëm të pafavorshëm duhet të deklarohen.

2500 – Procesi i monitorimit

Kryeshefi i auditimit duhet të themelojë dhe mirëmbajë një sistem që bënë monitorimin e natyrës së rezultateve të komunikuara tek stafi i lartë menaxhues.

2500.A1- Kryeshefi i auditimit duhet të themelojë procese përcjellëse për monitorim dhe të sigurohet se veprimet e stafit të lartë menaxhues janë implementuar në mënyrë efektive apo që stafi i lartë menaxhues ka pranuar rrezikun për mos marrjen e veprimeve.

2500.C1- Aktiviteti i auditimit të brendshëm duhet të monitorojë natyrën e rezultateve të konsultimit të angazhimit deri në atë masë që janë pajtuar më herët më klientin.

2600 - Komunikimi i pranimi të riskut

Kur kryeshefi i auditimit konstaton se menaxhmenti ka pranuar një nivel të rrezikut që mund të jetë i papranueshëm për organizatën, kryeshefi i auditimit duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin e lartë. Nëse kryeshefi i auditimit përcakton se çështja nuk është zgjidhur, kryeshefi i auditimit duhet të komunikojë çështjen në bord.

Interpretimi:

Identifikimi i rrezikut të pranuar nga menaxhmenti mund të vërehet përmes angazhimit të sigurisë ose konsulente, monitorimit të progresit mbi veprimet e ndërmarra nga menaxhmenti, si rezultat i angazhimeve të mëparshme, apo mjete të tjera. Kjo nuk është përgjegjësi e kryeshefit të auditimit për të zgjidhur rrezikun.

Fjalori

Vlerë e shtuar

Aktiviteti i auditimit të brendshëm i shton vlerën organizatës (dhe akterëve të tij) kur ofron siguri objektive dhe të rëndësishme, dhe kontribuon në efektivitetin dhe efikasitetin e qeverisjes, menaxhimit të rrezikut, dhe proceset e kontrollit.

Kontrulli i përshtatshëm

Është i pranueshëm nëse stafi i lartë menaxhues ka planifikuar dhe organizuar (dizajnuar) në atë mënyrë që ofron siguri të përshtatshme që rreziku organizativ është menaxhuar në mënyrë efektive dhe se qëllimet dhe objektivat e organizatës do të jenë të arritshme në mënyrë efikase dhe ekonomike.

Shërbimet e Sigurisë

Ekzaminimi objektiv i evidencës për qëllime të ofrimit të një vlerësimi të pavarur të qeverisjes, menaxhimit të rrezikut dhe proceset kontrolluese për organizatën. Shembujt mund të përfshijnë angazhime financiare, të performancës, të përshtatshmërisë, të sistemit të sigurisë, dhe për kujdesin e duhur.

Bordi

Niveli më i lartë i organit qeverisës (p.sh., bordi i drejtorëve, bordi mbikëqyrës, bordi i guvernatorëve ose administratorët) i ngarkuar me përgjegjësinë për të drejtuar dhe / ose mbikëqyr aktivitetet e organizatës dhe të mbajë menaxhmentin e lartë të organizatës përgjegjës. Edhe pse aranzhimet e qeverisjes ndryshojnë ndërmjet juridiksioneve dhe sektorëve, në mënyrë tipike bordi përfshin anëtarë të cilët nuk janë pjesë e menaxhimit. Nëse një bord nuk ekziston, fjala "bord" në Standardet i referohet një grupi apo personi i ngarkuar me qeverisjen e organizatës. Për më tepër, "bordi" në Standardet mund t'i referohet një komisioni ose ndonjë organi tjetër për të cilin organi qeverisës i ka deleguar funksione të caktuara (p.sh., një Komitet Auditimi).

Statuti

Statuti i auditorit të brendshëm është një dokument formal i cili definon qëllimet e aktivitetit të auditorit të brendshëm, autoritetin dhe përgjegjësitë. Statuti i auditorit të brendshëm themelon pozitën e auditorit të brendshëm përbrenda organizatës; autorizon qasjen në regjistra, personelin, dhe pasuritë fizike relevante për performancën e angazhimeve; dhe definon fushëveprimin e aktiviteteve të auditimit të brendshëm.

Kryeshefi i Auditimit

Kryeshefi i auditimit përshkruan rolin e një personi në një pozitë të lartë përgjegjëse për menaxhimin efektiv të aktivitetit të auditimit të brendshëm, në përputhje me statutin e auditimit të brendshëm dhe elementeve të detyrueshme të Kornizës Ndërkombëtare të Praktikave Profesionale. Kryeshefi i auditimit ose të tjerët që i raportojnë shefit ekzekutiv të auditimit do të kenë certifikatat dhe kualifikimet e duhura profesionale. Titulli specifik i punës dhe / ose përgjegjësitë e kryeshefit të auditimit mund të ndryshojnë në të gjithë organizatat.

Kodi i Etikës

Kodi i Etikës i Institutit të Auditorëve të Brendshëm (IAB) është dispozita relevante me profesionin dhe praktikën e auditimit të brendshëm, dhe Rregullat e Mirësjelljes që përshkruajnë sjelljet e pritshme të auditorëve të brendshëm. Kodi i Etikës aplikohet tek të dyja palët dhe subjektet që ofrojnë

Standardet Ndërkombëtare për Praktikën Profesionale të Auditimit të Brendshëm (Standardet) shërbime të auditimit të brendshëm. Qëllimi i Kodit të Etikës është të promovojë kulturë etike në profesionin global të auditimit të brendshëm.

Përshtatshmëria

Zbatimi i rregulloreve, planeve, procedurave, ligjeve, direktivave, kontratave, apo kërkesave të tjera.

Konflikti i Interesit

Çfarëdo relacioni i cili nuk është, apo mund të mos jetë, në interesin më të mirë të organizatës. Konflikti i interesit do të paragjykonte aftësitë e një individi për të kryer detyrat dhe përgjegjësitë e tij/saj në mënyrë objektive.

Shërbimet Këshilluese

Aktivitetet këshilluese dhe të ndërlidhura me shërbimet e klientit, natyra dhe fushëveprimi i së cilës janë pajtuar me klientin ekzistojnë me qëllim të ngritjes së vlerës dhe përmirësimit e qeverisjes së organizatës, menaxhimit të rrezikut, dhe proceset e kontrollit pa auditor të brendshëm duke supozuar përgjegjësitë e stafi të lartë menaxhues. Shembujt përfshijnë konsulencën, këshillimin, lehtësimin dhe trajnimin.

Kontrolli

Çfarëdo aktiviteti i ndërmarrë nga stafi i lartë menaxhues, bordi, dhe palët e tjera për të menaxhuar rrezikun dhe për të ngritur gjasat për arritjen e objektivave dhe qëllimeve të themeluara. Menaxhmenti planifikon, organizon, dhe drejtojnë performancën e veprimeve të mjaftueshme për të ofruar siguri të arsyeshme për të arritur objektivat dhe qëllimet.

Kontrolli i ambientit

Qëndrimi dhe veprimet e bordit dhe stafit të lartë menaxhues në lidhje me rëndësinë e kontrollit përbrenda organizatës. Kontrolli e ambientit ofron disiplinë dhe strukturë për arritjen e objektivave primare të sistemit të kontrollit të brendshëm. Kontrolli i hapësirës përfshinë elementet në vijim:

- Integritet dhe vlera etike.
- Filozofinë dhe stilin operues të stafit të lartë menaxhues.
- Strukturën organizative.
- Përcaktimin e autoritetit dhe përgjegjësitë.
- Rregulloret dhe praktikatat e Burimeve Njerëzore.
- Kompetencat e personelit.

Proceset e kontrollit

Politikat, procedurat (të dyja manual dhe të automatizuar), dhe aktivitetet që janë pjesë e një kuadri kontrolli, i hartuar dhe operuar për të siguruar që rreziqet janë të përfshira brenda nivelit që një organizatë është i gatshëm të pranojë.

Parimet themelore për Praktikën Profesionale të Auditimit të Brendshëm

Parimet themelore për Praktikën Profesionale të Auditimit të Brendshëm janë bazë për Kornizën Ndërkombëtare për Praktikën Profesionale dhe mbështetin efikasitetin e auditimit të brendshëm.

Angazhimi

Përcaktimi special i auditimit të brendshëm, detyrave, apo rishikimi i aktivitetit, siç është auditimi i brendshëm, rishikimi i kontrollit të vetë-vlerësimit, ekzaminimi i mashtrimit, apo konsulencës-këshillimi. Angazhimi mund të përfshijë detyra të shumëfishta apo aktivitete të projektuara për arritjen e një grupi specifik të objektivave.

Standardet Ndërkombëtare për Praktikën Profesionale të Auditimit të Brendshëm (Standardet Objektivat e angazhimit)

Deklaratat e gjera të zhvilluara nga auditorët e brendshëm që definojnë qëllimin e arritjeve të angazhimit.

Opinion mbi angazhimin

Vlerësimi, konkluzioni dhe / ose të tjera përshkrime të rezultateve të angazhimit individual të auditimit të brendshëm, në lidhje me ato aspekte brenda objektivave dhe fushëveprimit të angazhimit.

Programi i punës së angazhimit

Një dokument që numëron procedurat që duhet të përcillen gjatë angazhimit, të dizajnuara për të arritur planin e angazhimit.

Ofrues i jashtëm i shërbimeve

Një person apo firmë jashtë organizatës që ka njohuri speciale, aftësi dhe përvojë në një disiplinë të caktuar.

Mashtrim

Çfarëdo veprimi ilegal i karakterizuar nga mashtrimi, fshehja, apo shkelje e besimit. Këto akte nuk janë të varura nga kërcënimi i dhunës apo dhunës fizike. Mashtrimet janë të kryera nga palët dhe organizatat për të përfituar para, pasuri apo shërbime; për të shmangur pagesat apo humbjen e shërbimeve; apo për të siguruar përfitim personal apo të biznesit.

Qeverisja

Një kombinim i proceseve dhe strukturave të implementuara nga bordi për të informuar, drejtuar, menaxhuar, dhe monitoruar aktivitetet e organizatës drejt arritjes së objektivave të sajë.

Dëmtimi

Dëmtimi i pavarësisë së organizatës dhe objektiviteti individual mund të përfshijë konfliktin personal të interesave, kufizimin e fushëveprimit, ndalesat në qasjen e regjistrave, personelit, dhe pasurive, dhe kufizimin e burimeve (financimi).

Pavarësia

Liria nga kushtet që kërcënojnë aftësinë e aktivitetit të auditimit të brendshëm për të kryer përgjegjësitë e auditimit të brendshëm në mënyrë të paanshme.

Kontrolli i Teknologjisë Informative

Kontrollet që mbështesin menaxhimin e biznesit dhe qeverisjen e gjithashtu edhe ofron kontrolle të përgjithshme dhe teknike në lidhje me infrastrukturën e teknologjisë informative siç janë aplikacionet, informatat, infrastruktura, dhe njerëzit.

Qeverisja e Teknologjisë Informative

E përbërë prej udhëheqësisë, strukturat organizative, dhe proceset të cilat sigurojnë që teknologjia informative e ndërmarrjes përmban dhe mbështet strategjitë e organizatës dhe objektivat.

Aktivitetet e auditimit të brendshëm

Një departament, divizion, ekip konsulentësh, apo praktikues të tjerë të cilët ofrojnë siguri të pavarur dhe objektiv, dhe shërbime të dizajnuara për të shtuar vlerën dhe përmirësoj operimet e një organizate. Aktivitetet e auditimit të brendshëm ndihmon një organizatë për të arritur objektivat e saja duke sjellë sistematikisht, qasje të disiplinuar për të vlerësuar dhe përmirësuar efektivitetin e qeverisjes, menaxhimin e rrezikut dhe proceset e kontrollit.

Korniza ndërkombëtare e praktikës profesionale

Korniza përmbajtësore që organizon direktiva autoritative të lëshuara nga IIA.

Rishikuar: Tetor 2016

Në fuqi, zbatim: Janar 2017

23

Standardet Ndërkombëtare për Praktikën Profesionale të Auditimit të Brendshëm (Standardet) Direktiva Autoritative përbëhet nga dy kategori - (1) e obligueshme dhe (2) e rekomanduar.

Duhet patjetër

Standardet përdorin fjalën "duhet patjetër" (must) për të specifikuar një kërkesë të pakushtëzuar.

Objektiviteti

Një sjellje e paanshme intelektuale e cila lejon auditorët e brendshëm që të kryejnë angazhimet në atë mënyrë që ata të kenë besim në prodhimin e punës së tyre dhe se nuk kanë pasur komprometim të kualitetit. Objektiviteti kërkon nga auditorët e brendshëm që paragjykimet e tyre mos të ndikojnë në çështjet e auditimit tek të tjerët.

Opinion i përgjithshëm

Vlerësimi, konkluzioni, dhe / ose përshkrimi i rezultateve të tjera të ofruara nga kryeshefi i auditimit drejtuar një niveli të gjerë të bordit, qeverisjes, menaxhimit të riskut, dhe / ose proceseve të kontrollit të organizatës. Një opinion i përgjithshëm është gjykim i kryeshefit të auditimit bazuar në rezultatet e një numri të angazhimeve individuale dhe aktivitete të tjera për një interval të caktuar kohor.

Rreziku

Mundësia e ndodhjes së një ndodhie e cila do të ketë ndikim në arritjen e objektivave. Rreziku matet në termet e ndikimit dhe probabilitetit.

Rreziku i pranueshëm

Niveli rrezikut që një organizatë është e gatshme të pranoj.

Menaxhimi i Rrezikut

Një proces për të identifikuar, vlerësuar, menaxhuar dhe kontrolluar ndodhitë apo situatat e mundshme për të ofruar siguri të arsyeshme në lidhje me arritjen e objektivave të organizatës.

Duhet ('should')

Sipas *Standardeve* fjala duhet ('should') përdoret atëherë kur pritet përputhshmëria përveç nëse gjatë zbatimit të gjykitimit profesional, rethanat e justifikojnë devijimin.

Rëndësia

Rëndësia relative e një çështje përbrenda përmbajtjes të së cilës është duke u konsideruar, duke përfshirë edhe faktorët e kualitetit dhe kuantitetit, siç është magnituda, natyra, efekti, lidhja, dhe ndikimi. Paragjykimet profesionale ndihmojnë auditorët e brendshëm kur vlerësojnë rëndësinë e çështjes përbrenda kontekstit të objektivave relevante.

Standardet

Një prononcim profesional i përmbledhur nga Bordi Ndërkombëtar për Standardet e Auditimit të Brendshëm të cilat definojnë kërkesat për kryerjen e një game të gjerë të aktiviteteve të auditimit të brendshëm, dhe për vlerësimin e performancës së auditimit të brendshëm.

Teknikat e auditimit të bazuara në teknologji

Çfarëdo mjeti i automatizuar i auditimit, siç janë softuerët e gjeneralizuar të auditimit, gjeneratorët e test informatave, programet e kompjuterizuara për auditim, pajisjet speciale të auditimit, dhe teknikat e auditimit të asistuar nga kompjuteri (CAATs-TAAK).